

SONILA BOÇI

**GRUPIMET POLITIKE DHE TIPARET E REZISTENCËS
SHQIPTARE KUNDËR PUSHTUESIT ITALIAN
(1942-1943)**

Shqipëria në fund të vitit 1942 dhe në fillim të vitit 1943

Gjatë viteve 1942-1943, pozita e Italisë në Shqipëri ishte dobësuar së tepërmi. Përkundër premtimeve të bujshme të viteve të para të pushtimit për rritje të mirëqenies së shqiptarëve, gjatë gjysmës së dytë të vitit 1942 dhe sidomos në fillim të vitit 1943 situata ekonomike në Shqipëri po shkonte drejt një gjendjeje kaotike. Pas përfundimit të Luftës Italo-Greke, në pranverë 1941, Italia e Musolinit nuk kishte mundur të mbështeste financiarisht investime të tjera në Shqipëri. Mëkëmbësi i Përgjithshëm, Francesco Jacomoni, në një nga raportet që i dërgonte ministrit të Jashtëm, Galeazzo Ciano vinte në dukje mungesat e shumta ushqimore në tregun shqiptar. “Për çështjen e konsumit, - shkruante ai, - shumë artikuj mungojnë, por mund të mbështetesh, brenda disa mundësive në përkoren ekstreme të shqiptarëve. Për këtë arsye nuk e gjejkoj oportunitet vendosjen e triskave. T’i triskëtosh ushqimet në bazë të modelit italian (dhe do të ishte jopolitike ta bëje në baza më të ulëta), do të thoshte të shtojte konsumin”¹.

Si pasojë e gjendjes ekonomike, por edhe rritjes së lëvizjes së rezistencës shqiptare kundër pushtuesit, administrata italiane e kishte gjithnjë e më të vështirë të ruante qetësinë dhe të mbante rendin në vend. Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Policisë shpreheshin të shqetësuara për shtimin e veprimtarisë së çetave të ndryshme² dhe

¹ *Archivio Storico e Diplomatico del Ministero degli Affari Esteri* (më tej: ASDMAE), Serie (më tej: S.): Gabinetto Albania, Busta (më tej: B.) 107, fascicolo (më tej: fasc.) Rapporti di Luogotenente Generale, Raport i Mëkëmbësit të Përgjithshëm, Jacomoni për ministrin e Jashtëm, kontin Ciano, 30 dhjetor 1941.

² *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 152, Viti (më tej: V.), 1942, Dosja (më tej: D.) 285, Dosja përmban informacione dhe njoftime të njësisë të karabinierisë dhe të xhandarmërisë për aktivitetin e çetave të ndryshme. Aty gjen shpesh të përmendura emrat e Mestan Ujanikut dhe çetës së tij të

veçanërisht për shtimin e aktivitetit të komunistëve. Ajo që kishte shqetësuar më së shumti administratën e pushtimit ishte një lloj frikësimi që ndihej në radhët e policisë dhe mungesa e vullnetit nga ana e tyre për të kryer detyrën. Kjo për shkak se veprimtaria e komunistëve drejtohej kryesisht ndaj institucionit të policisë³.

Gjatë vitit 1942, po shihej gjithnjë e më qartë se qeverisja e kryeministrit Mustafa Kruja nuk po arrinte objektivat që i ishin ngarkuar kur mori detyrën më 4 dhjetor 1941. Masat e tij represive për vendosjen e qetësisë në vend dhe për kontrollin mbi bandat [lëvizjen e rezistencës] rezultuan jo efikase. Milicia Shqiptare, e krijuar për të mbrojtur kufijtë e “Shqipërisë së Madhe”, për shkak të reprezaljeve ndaj popullsisë, u shndërrua në tmerr, veçanërisht në jug të vendit. Kruja dështoi edhe në objektivin e dytë që kishte vendosur në programin e tij të qeverisjes⁴: negociimi me autoritetet italiane për të bashkuar me Shqipërinë e krijuari rishtazi të gjitha territoret e banuara nga shqiptarë, gjë që shtoi pakënaqësinë popullore ndaj tij. Jacomoni u përpoq të zbuste efektet e pakënaqësisë së shqiptarëve duke i kërkuar qendrës disa lëshime kombëtare, por nuk mundi t’i sigurojë ato⁵. E vetmja arritje e qeverisjes së Krujës ishte heqja e fashos* së Liktorit nga flamuri kombëtar, në qershor 1942.

Viti 1943 u bë edhe më i vështirë për administratën italiane në Shqipëri. Ata ishin në presionin e vazhdueshëm dhe gjithmonë në rritje të rezistencës shqiptare, por edhe të vështirësive që po kalonte regjimi në

Skraparit, e cila ka sulmuar herë pas here garnizonet e pushtuesit. Gjenden të dhëna për veprimtarinë e Haxhi Lleshit dhe lidhjet e tij si me Myslim Pezën, ashtu dhe me Abaz Kupin. Flitet edhe për veprimtarinë kundra autoriteteve italiane të Mustafa Khanit (Baba Faja i Martaneshit), i cili thirret si Myfiu [siç] i Martaneshit. Jepen të dhëna dhe për lëvizje dhe aktivitete të çetave të tjera në Korçë, Kolonjë, Lushnjë, Vlorë etj., por kryetarët dhe anëtarët e tyre janë të pidentifikuar për autoritetet italiane të kohës.

³ *AQSH*, F. 152, V. 1942, D. 253, fl. 1, Raport i kuesturës së Shkodrës për Ministrinë e Brendshme, 16 mars 1942.

⁴ *ASDME*, S. Gabinetto Albania, B. 107, fasc. Rapporti di Luogotenente Generale, Raport i Mëkëmbësit të Përgjithshëm, Jacomoni për ministrin e Jashtëm, kontin Ciano, 30 dhjetor 1941.

⁵ *Po aty*, Raport i Mëkëmbësit të Përgjithshëm, Jacomoni për ministrin e Jashtëm, kontin Ciano, 12 prill 1942.

* Në qershor të vitit 1941, në kuadër të programit për aneksimin e Shqipërisë nga Italia e Musolinit, u ndryshuan dhe simbolet e Monarkisë Shqiptare. Flamurit kombëtar u shtuan dy sëpatat e Liktorit, simbol i madhësisë së Perandorisë Romake.

qendër, pra në Romë⁶. Pakënaqësia ndaj Italisë së Musolinit ishte e përgjithshme dhe dukej se vetëm rritej. Në këto kushte, Musolinit iu desh të bënte ndryshime në qeverinë qendrore, por edhe në atë shqiptare. Ciano u largua nga ministri i Jashtëm, pas një votimi kundër Musolinit në Këshillin e Epërm Fashist; pas tij, në fillim Kruja dhe më pas Jacomoni, u detyruan të lënë detyrat e tyre. Kruja u zëvendësua nga Maliq Bushati, ndërsa Jacomoni nga Pariani. Në Shqipëri dërgohet gjeneral Renzo Dalmazzo, si shef i Shtatmadhorisë italiane me detyrën për të vendosur rendin në vend. Italia vendosi ta braktiste politikën e saj “të gurit dhe arrës” dhe të përdorte ndaj shqiptarëve “le maniere forti [dorën e fortë]”. Situata megjithatë kishte dalë jashtë kontrollit dhe vera e vitit 1943, shënoi kriza të shpeshta qeveritare dhe rritje të vazhdueshme të rezistencës kundër pushtuesve në vend.

Partia Komuniste e Shqipërisë në rrugën drejt krijimit të Frontit Nacionalçlirimtar

PKSH, ashtu si të gjitha partitë komuniste në Botë, mbështetej në filozofinë marksiste-leniniste. Programi i saj afatgjatë përfshinte: internacionalizmin proletar, luftën e klasave, diktaturën e proletariatit, dhe marrjen me dhunë (revolucion) të pushtetit. Por kushtet historike në të cilat u krijua Partia Komuniste e Shqipërisë (PKSH), diktuan edhe përcaktimin e përparësive në vijën e saj politike. Kjo linjë politike e adaptuar nga PKSH nuk ishte ideja e saj, madje nuk kishte lindur gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ajo kishte të bënte me platformën të adoptuar nga Kominterni që në vitin 1935⁷, por që u rivitalizua më 1941. Këtë

⁶ Për më tepër *shih*: Pierre Milza, *Historia e Italisë nga origjina në ditët tona*, Tiranë: Dituria, 2012, f. 808-809.

⁷ Në Kongresin VII të Kominternit në vitin 1935, dy nga drejtuesit e tij kryesorë, Gjergj Dimitrovi dhe Dimitri Manuilski, nxitën të pranohej platforma e fronteve popullore. Ndryshe nga sa ishte menduar deri atëherë, komunistët mund të vinin në pushtet jo vetëm me anë të revolucioneve të dhunshme popullore dhe mbarëpopullore. Dy drejtuesit parashtruan edhe parlamentarizmin si rrugë të ardhjes në pushtet të komunistëve. Kështu, partitë komuniste do të nxiteshin të krijonin koalicione me socialistët, socialdemokratët, apo dhe demokratët, pra kryesisht parti të spektrit politik të majtë, të cilat do të bashkëvepronin për të penguar ardhjen në pushtet të partive fashiste e naziste, ose edhe një ndërhyrje të armatosur të tyre nga jashtë. Ndryshimi u diktua nga nevojat e luftës civile në Spanjë, por edhe nga nevojat e komunistëve italianë dhe atyre francezë. Në vitin 1939, pas paktit sovjeto-gjerman të mossulmimit, ose siç njihet në histori, paktit Molotov-Ribentrop, praktikisht kjo platformë e

platformë parashtroan në mbledhjen themeluese të PKSH dy të dërguarit e PKJ, Dushan Mugosha dhe Miladin Popović⁸. Ky i fundit gjatë mbledhjes mbajti pozicionimin si i dërguari i Kominternit dhe në referatin hyrës të mbledhjes theksoi nevojën për krijimin edhe në Shqipëri të një fronti nacionalçlirimtar siç ishte krijuar, sipas tij, në të gjithë vendet prej demokratëve përparimdashës, në luftë kundër armikut të betuar të njerëzimit, fashizmit⁹. Ndër detyrat imediate që i vuri Popovići, në emër të Kominternit, partisë së sapokrijuar ishin: forcimi i partisë dhe zgjerimi i influencës së saj ndër masat; mobilizimi i masave në luftë kundër pushtuesit; lidhja e luftës çlirimtare të popullit shqiptar me atë të popujve të tjerë të robëruar¹⁰.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 1942, drejtuesit e PKSH duket se e kishin lënë në plan të dytë detyrën për krijimin e frontit popullor nacionalçlirimtar. Puna e saj ishte përqendruar në strukturimin e partisë së sapokrijuar, organizimin e saj dhe sigurimin e mbështetjes së masave për PKSH. Në direktivat e lëshuara nga KQ i përkohshëm i PKSH-së në

Kominternit u bë nul, për t'u rivitalizuar pas qershorit të vitit 1941, pra, pas sulmit të Gjermanisë së Hitlerit ndaj Bashkimit Sovjetik të Stalinit, por tani në formën e fronteve të gjera nacionalçlirimtare. Për më tepër *shih*: "Fronte Nazionale", në *Dizionario del comunismo nell XX secolo*, a cura di Silvio Pons e Robert Service, Torino: Einaudi, f. 317-321.

⁸ Pavarësisht rolit të madh që luajtën dy të dërguarit jugosllavë në organizimin dhe drejtimin e PKSH gjatë luftës, në mënyrë paradoksale, statusi i tyre zyrtar jo vetëm në mbledhje, por deri në fund të luftës mbeti disi konfuz dhe i papërcaktuar. Nuk ishte e qartë nëse ata ishin të dërguarit e Kominternit, apo të PKJ-së. Në një letër, e cila përmbante një informacion mbi situatën politike në Shqipëri, Miladin Popović fliste ndër të tjera edhe për statusin e tij pranë PKSH: "Ju vetë e dini se unë nuk kam kurrfarë autorizimi. Unë ia kam thënë këtë Tempos në bisedë. Ai më pyeti për këtë. Ju përgjigja që nuk kam kurrfarë autorizimi (si edhe asgjë të shkruar nga Tito), me përjashtim që Tito ia ka paraqitur Vlada Popović-it, Dušan-in si delegat për punë në Shqipëri së bashku me Miladinin ... Në letrën e dërguar përmes Dušan-it kam kërkuar nga Tito autorizim ose të paktën diçka për punën në Shqipëri. Asgjë nuk kam marrë. ...". Për më tepër *shih*: Ana Lalaj, *Dosjet e Luftës, studime, artikuj, dokumente*, Tiranë: Toena, 2014, f. 404-407, Letër e Miladin Popović për Ivan Milutonović për situatën politike në Shqipëri dhe statusin e saj, 29 korrik 1943.

⁹ *AQSH*, F. 14/Arkivi i PKSH gjatë Luftës (më tej: APL), V. 1942, D. 2, fl. 1, Fjala e mbajtur nga Miladin Popović në mbledhjen themeluese të PKSH.

¹⁰ Zyrtarisht direktivat e Kominternit i vijnë PKSH në dhjetor 1942 me anë të një letre të Titos, të cilën në Shqipëri e solli i dërguari i PKJ-së, Bllazho Jovanović. Të gjitha këto udhëzime u diskutuan fillimisht në një mbledhje të KQ të PKSH të mbledhur në Shmil të Elbasanit dhe, më pas, në Konferencën I të PKSH, të mbajtur në Labinot të Elbasanit, në mars 1943.

periudhën janar-prill 1942 theksi vihej në mbledhjen e ndihmave financiare për partinë¹¹, apo “popullarizimi” i Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike (BRSS) dhe Ushtrisë së Kuqe¹². Në shkurt 1942 në një letër të gjatë të drejtuesve të përkohshëm komunistë jepej direktiva që “të luftohet me këmbëngulje për krijimin e frontit të përbashkët popullor nacionalçlirimtar”. Kjo ishte një punë që do të bëhej paralelisht me krijimin e njësiteve guerile dhe çetave partizane. Madje, në të njëjtën qarkore përmendet dhe direktiva për krijimin e këshillave nacionalçlirimtarë, por këta në këtë fazë do të ishin “lidhjet e partisë me masat”¹³, pra këshilla që ngjanin më shumë si sovjetët në BRSS. Ndërsa përmendej lufta nacionalçlirimtare, udhëzimet jepeshin për të bërë propagandë për “një qeverim të vërtetë demokratik popullor”¹⁴. Po kështu edhe traktet e shpërndara nga PKSHP në këtë periudhë flasin më shumë për marrëdhëniet ndërkombëtare dhe për luftën e BRSS-së sesa për organizimin e popullit shqiptar në luftë. Në këto udhëzime shihej qartë zbatimi i modelit jugosllav në Shqipëri, por duke anashkaluar në një masë të konsiderueshme vështirësitë dhe specifikat që kishte vendi.

Direktivat që kishte dhënë KQ i përkohshëm i PKSHP nën kujdesin e dy të dërguarve jugosllavë, kishin shkaktuar pakënaqësi në radhët e komunistëve të vjetër. Kështu, në mars 1942, Koço Tashko dëshmon se kishte kundërshtuar Miladin Popović-in për drejtimin që po i jepte Partisë, duke i kujtuar se modeli jugosllav nuk ishte i përshtatshëm për Shqipërinë¹⁵. Por, pavarësisht kësaj, edhe në mbledhjet e rëndësishme të PKSHP, siç ishte ajo e prillit dhe e qershorit 1942, thelbi i diskutimeve

¹¹ Në janar 1942, me rastin e përvjetorit të vdekjes së Leninit, Komiteti i përkohshëm Qendror i PKSHP, nxori një direktivë sipas së cilës java nga 21-29 janar 1942 shpallej Java e Partisë. Në thelb kjo do të ishte një fushatë për mbledhje ndihmash për partinë e re, por, përveç kësaj, komunistët duhet ta përdornin atë për të popullarizuar PKSHP si udhëheqësen e vetme të Luftës Nacionalçlirimtare, për të popullarizuar luftën e popujve fqinjë dhe atë të BRSS “pararojës së lavdishme për çlirimin e popujve të robëruar”. *Shih: AQSH, F. 14/APL, V. 1942, D. 3, fl. 1, Direktiva të KQ të PKSHP për komitetet lokale të PKSHP, pa datë.*

¹² *Po aty, fl. 2.*

¹³ *AQSH, F. 14/APL, V. 1942, D. 3, fl. 7, Direktiva të KQ të PKSHP për komitetet lokale të PKSHP, pa datë.*

¹⁴ *Po aty, fl. 8.*

¹⁵ *Po aty, F. 14/APL, V. 1942, D. 5, fl. 1, Letër e Koço Tashkos për Internacionalen Komuniste, tetor 1942. K. Tashko kundërshtonte në këto pika direktivat e PKSHP: çështja e Kosovës, çështja e ushtrisë shqiptare, puna me nacionalistët, lufta nacionalçlirimtare, nënçmimi i armikut të jashtëm.*

ishte konsolidimi i brendshëm i PKSH, lufta kundër grupeve komuniste, të cilat nuk u bashkuan me të, siç ishte p.sh. grupi komunist i Zjarrit dhe lufta kundër tendencave grupiste brenda PKSH, duke vënë theksin te tendencat fraksioniste të grupit komunist të të Rinjve dhe veçanërisht për drejtuesit e saj, Anastas Lulo dhe Sadik Premte¹⁶.

Politika e ndjekur deri në këtë kohë nga PKSH për ta tërhequr popullin në krah të saj nuk po jepte rezultatet e pritshme. Raportet nuk mungonin të vinin në dukje ndikimin ende të pakët që kishte partia në masat e popullit¹⁷. Ata fajësonin për këtë terrorin e pushtuesit, si pasojë e të cilit kishin humbur një pjesë të kuadrove; mungesën e eksperiencës së drejtuesve, e cila kishte ndikuar në mungesën e organizimit të strukturave¹⁸.

Nga dokumentet e pakta që zotërohen për këtë periudhë është e vështirë të përcaktosh kohën e saktë kur filloi puna për organizimin e Konferencës së Pezës. Koço Tashko flet për një mbledhje të zhvilluar mes shokëve të ngarkuar për punën me nacionalistët¹⁹, Miladin Popovićit dhe Qemal Stafës, në prill 1942. Aty u diskutua mbi grupet e mundshme të nacionalistëve me të cilat mund të bisedohej për të arritur një marrëveshje bashkëpunimi. Në analizën e tij, Koço Tashko i ndante këta në katër grupe:

1. kompromisaxhinjtë dhe bashkëpunëtorët e autoriteteve italiane të pushtimit;
2. nacionalistët të cilët janë goditur nga fashizmi, ku ai përfshinte Muharrem Bajraktarin, Abaz Kupin, Myslim Pezën, Haxhi Lleshin etj.;
3. klerin katolik françeskan, i cili është treguar antifashist dhe kundër jezuitëve;
4. si dhe grupin e Mehdi Frashërit²⁰. U propozua që të thirrej një konferencë duke u mbështetur në grupin e dytë të nacionalistëve.

¹⁶*Po aty*, F. 14/APL, V. 1942, D. 3/1, fl. 1, Direktiva të KQ të PKSH për komitetet lokale të PKSH, pa datë.

¹⁷*Po aty*, F. 14/APL, V. 1942, D. 4/1, fl. 1, Raport në emër të KQ të përkohshëm të PKSH, mbajtur në Aktivin e PKSH, prill 1942.

¹⁸*Po aty*.

¹⁹ Është fjala për Ymer Dishnicën, Koço Tashkon dhe Mustafa Gjinishin. *Shih*: Paskal Milo, *Shqipëria në Luftën e Dytë Botërore*, vëll. 1, Tiranë: Toena, 2014, f. 281.

²⁰*AQSH*, F. 14/APL, V. 1942, D. 2, fl. 2, Letër e Koço Tashkos drejtuar Kominternit, pa datë.

Enver Hoxha në kujtimet e tij i jep kredite vetes për idenë, organizimin dhe përgatitjen e Konferencës së Pezës. Ai flet për një mbledhje të KQ të PKSH të korrikut 1942, në të cilën u mor vendimi për thirrjen e një konference me nacionalistët²¹. Ai vë në dukje se kjo është e njëjta konferencë ku u mor vendimi për përjashtimin e Anastas Lulos dhe Sadik Premtes nga radhët e PKSH. Historia e PPSH-së përmend faktin që në Konferencën e Jashtëzakonshme të PKSH, të mbajtur më 28-29 qershor 1942, është marrë një vendim i tillë. Ndërsa dokumentet e pakta që kemi nga këto dy mbledhje nuk japin të dhëna për një vendim të tillë. Sa i takon thirrjes së Konferencës së Pezës, Enver Hoxhën e kundërshton vetë Enver Hoxha në fjalën e tij të mbajtur në Plenumin e Beratit (nëntor 1944). Aty ai pohon se ishte në Tiranë kur kishte marrë një letër nga Popović-i, i cili gjendej në Pezë. “Nuk kishim folur më përpara, - shprehet Hoxha. Mora një letër, një pusullë ku më thoshte që të lajmëroja filanin dhe filanin se do të bënim një konferencë. Kur shkova në Pezë qenë përgatitur referatet dhe i gjeta këta shokë që po haheshin dhe po grindeshin për një çështje me rëndësi që s’e mbaj mend: ta vemë këtë apo të mos ta vemë. Pas një dite dolëm në konferencë për të mbrojtur platformën tonë të Lëvizjes Nacionalçlirimtare”²².

Për zhvillimet e bisedimeve gjatë ditëve të Konferencës së Pezës është folur e shkruar shumë. Është i njohur tashmë vendimi më i rëndësishëm i kësaj konference: bashkimi i të gjithë shqiptarëve pa dallim feje, krahine dhe ideje politike në luftë kundër pushtuesit, për një Shqipëri të lirë, të pandashme, të pavarur dhe demokratike²³. Këto ishin aspiratat e pjesëmarrësve në Konferencën e Pezës dhe rezultati i menjëhershëm i saj ishte që iu dha hov rezistencës të armatosur kundër pushtuesit italian. Por, edhe pas kësaj konference, tek qëndrimet e PKSH evidencohet njëfarë dualizmi për punën me nacionalistët dhe propagandën në popull.

Situata ndryshoi nga fundi i vitit. Më 16 dhjetor 1942, në Labinot ku ishte vendosur KQ i PKSH mbërriti një delegacion i Partisë

²¹ Enver Hoxha, *Kur hidheshin themelet e Shqipërisë së Re*, Tiranë: 8 Nëntori, 1984, f. 134.

²² *Politikë antikombëtare e Enver Hoxhës. Plenumi i II i KQ të PPSH, Berat 23-27 nëntor 1944*, Tiranë: Eurorilindja, 1996, f. 153.

²³ *AQSH*, F. 40/APL, V. 1942, D. 1, fl. 3, Rezolucioni i Konferencës së Pezës; Muharrem Dezhgiu, *Shqipëria nën pushtimin italian (1939-1943)*, Tiranë: Mësonjëtorja, 2005, f. 239

Komuniste të Jugosllavisë (PKJ) i përbërë nga Bllazho Jovanović dhe Vojo Todorović, i shoqëruar nga Dushan Mugosha²⁴. Ata kishin me vete letrën e dërguar nga Tito, me njohjen zyrtare të Kominternit për PKSHP dhe direktivat e tij²⁵. I vetmi dokument, i njohur deri tani që na përcjell këto direktiva për komunistët shqiptarë në qarqe është një letër e Ymer Dishnicës për Pandi Kriston në fund të dhjetorit 1942, ose fillim të janarit 1943. Direktivat e Kominternit flisnin për organizimin dhe zhvillimin e Luftës Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar kundër italianëve dhe gjermanëve; krijimin dhe forcimin e frontit nacionalçlirimtar me të gjithë patriotët shqiptarë, “duke evituar tash për tash parullat që dalin jashtë kuadrin nacionalçlirimtar të Shqipërisë”²⁶; si dhe përfshirja në udhëheqje të luftës partizane përveç komunistëve sa më shumë patriotë dhe nacionalistë të ndershëm²⁷. Pavarësisht se në mënyrë të detajuar këto direktiva u punuan në mars 1943, në Aktivin I të PKSHP, kjo letër i dha tjetër drejtim vijës politike të PKSHP dhe shënoi formalizimin e idesë së Frontit Nacionalçlirimtar (FNÇ).

Propaganda e strukturave partiake u përqendrua kryesisht te organizimi i rezistencës së armatosur kundër pushtuesit dhe popullarizimi i PKSHP u la mënjanë. Gjithçka bëhej në emër të Frontit. Që nga ky moment, Lëvizja Nacionalçlirimtare filloi të cilësohej me emrin e saj të ri “Fronti Nacionalçlirimtar” dhe vetë PKSHP veshi mantelin e Frontit²⁸. Ky pozicion i mbuluar i PKSHP në radhët e FNÇ, me kalimin e kohës do t’i jepte mundësi PKSHP të faktorizohej, pasi numri i shqiptarëve që grumbulloheshin në FNÇ pa dallim feje, krahine dhe ideje ishte shumë më i madh se simpatizantët e PKSHP dhe anëtarësia e kufizuar e saj. Gjithashtu me zgjerimin e luftës çlirimtare, PKSHP gjysmë e fshehur në FNÇ do të shfrytëzonte të gjitha mundësitë për të realizuar më lehtësisht platformën e saj ideologjike dhe politike komuniste.

²⁴ P. Milo, *Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore ...*, f. 309.

²⁵ Sipas studiueses Ana Lalaj, Tito e kishte shkruar letrën për KQ të PKSHP më 22 shtator 1942. I dërguari i tij, Bllazho Jovanović u nis për në Shqipëri në tetor të vitit 1942 dhe mbërriti në muajin dhjetor. Për më tepër *shih*: A. Lalaj, *Dosjet e Luftës ...*, f. 52.

²⁶ *AQSH*, F. 20/APL, V. 1942, D. 1, fl. 1, Letër e Bardhos (Ymer Dishnicës) për Dunavecjin (Pandi Kriston), pa datë.

²⁷ *Po aty*.

²⁸ Kristo Frashëri, *Mbi historinë e Ballit Kombëtar, vështrim kritik*, Tiranë: Dudaj, 2012, f. 16.

Balli Kombëtar: sfida për të krijuar një organizatë të unifikuar

Të pakta janë organizatat apo partitë politike në Shqipëri që mund të kenë ngjallur aq shumë diskutime dhe të kenë qenë për një kohë kaq të gjatë objekt polemikash sa Balli Kombëtar. Gjatë periudhës së regjimit komunist, Balli Kombëtar, duke qenë një organizatë rivale me Frontin Nacionalçlirimtar u anatemua në çdo drejtim. Anëtarësimi në këtë organizatë ishte njolla më e keqe që dikush mund të kishte në biografinë e tij, ndërsa qenia në poste drejtuese të kësaj organizate do të thoshte gjykim i anuar, i cili mund të përfundonte me pushkatim, ose me vite të gjata burgimi dhe familja do të detyrohej ta kalonte jetën e saj në internim²⁹. Askush nga studiuesit e periudhës së Luftës së Dytë Botërore nuk mund të guxonte të bënte një analizë objektive për historinë e Ballit Kombëtar. Nëse kjo organizatë merrej në analizë ishte vetëm për të nxjerrë në pah dëmin që ajo i kishte bërë Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Shqyrtimi i fakteve *fillonte* nga vjeshta e vitit 1943, periudhën e pushtimit gjerman, kohë kur Balli zgjodhi të mos luftonte kundër pushtuesve të rinj e, më vonë të bashkëpunonte me ta. Tendencat bashkëpunuese të Ballit do të analizoheshin në retrospektivë dhe do të konsideroheshin të vërteta edhe për pushtimin italian.

Nëse nga historiografia e periudhës 1945-1990 morëm një përshkrim të njëanshëm për Ballin Kombëtar, edhe pas viteve '90, situata nuk u qartësua plotësisht. Veprimtarë të kësaj organizate ose pasardhës të tyre nxituan të botonin fakte të reja, të cilat përpiqeshin të hidhnin poshtë akuzat e bëra prej disa dekadave, por një pjesë e këtyre shkrimeve dallohen për të njëjtën dozë pasioni dhe anshmërie, sa dhe shkrimet për këtë temë të historianëve paraardhës të para viteve '90, veçse me një ndryshim kahu³⁰. Meritë e këtyre shkrimeve është nxitja e polemikave të cilat, edhe pse jo gjithmonë shkencore, tentojnë të ofrojnë fakte dhe

²⁹ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme* (më tej: *AMPB*), F. 4/02, V. 1954, D. 27, Statistika mbi krerët dhe anëtarët e Ballit Kombëtar. Dosja përmban të dhëna interesante për fatin e shumë prej anëtarëve dhe drejtuesve të Ballit Kombëtar. Shumë prej tyre ishin detyruar të largoheshin nga vendi, të tjerë ishin dënuar me pushkatim ose dënime të ndryshme, ndërsa të tjerë ishin të ndjekur nga Sigurimi i Shtetit.

³⁰ Hasan Dosti, *Një jetë për çështjen shqiptare*, Tiranë: Botart, 2008; Uran Butka, *Lufta civile në Shqipëri 1943-1945*, Tiranë: Drier, 2006; Safet Butka, përgatitur për botim nga Uran Butka, Tiranë: Maluka, 2003; Faik Quku, *Qëndresa shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore 2 (1941-1944)*, Tiranë: ILAR, 2006.

këndvështrime të reja, ndihmojnë në plotësimin e *puzzle-it* të kësaj historie të komplikuar.

Balli Kombëtar është konsideruar një organizatë e djathtë, por, nëse e gjykon atë nga Programi i tij prej 10 pikash (Dekalogu), mund të arrish në përfundimin se anonte më shumë nga socialdemokracia. Ky program bënte thirrje për ndryshime të karakterit liberal, si: demokracia, antifeudalizmi, drejtësia sociale etj. Ai kishte të përfshirë në program edhe “mobilizimin e të gjitha forcave të gjalla të Kombit kundra pushtuesit, për realizimin e idealit të lartë kombëtar: Shqipëria e shqiptarëve”³¹. Në zbërthimin e këtij programi për anëtarësinë, drejtuesit e Ballit Kombëtar shpjegojnë se qëllimi kryesor është “të grumbullojë në gjirin e saj gjithë elementët revolucionarë që kërkojnë të ndjekin [dëbojnë – S.B.] Italinë nga Shqipëria”³². Organizata bazohej në parimet e demokracisë të mbështetura në katër liritë [liritë e fjalës, besimit, civile dhe politike - S.B.]³³ dhe deklarohet në aleancë me Koalicionin e shteteve antifashiste në luftë kundër fuqive të Boshtit. Sa i takon çështjes kombëtare, Balli në fillimet e tij paraqet këtë qëndrim: “Fitorja e përbashkët do na gjejë në tryezën e paqes krah për krah me barazi të njëjtë si fituesa me të 28 fituesat të armikut dhe po ai pakt do na e ketë dhanë të drejtën që Kosova të mbetet në gjirin e Shqipërisë. Edhe çështja e Çamërisë do të rrihet n’atë tryezë, si një çështje midis shokëve që kanë derdhur gjakun e përbashkët kundra armikut të përbashkët. Mejtimi që shovinizma serbe do të zgjuhet për të na e marrë Kosovën do të gjejë kundërshtimin po t’atyre armëve tona që kanë ndjekur okupatorin fashist, të ndihmuara këtë herë edhe me armët e aleatëve demokratë që sot luftojnë jo vetëm për shkatërrimin fashist të çdo vendi por edhe për të mos lejuar më që të përsëritet forma fashiste siç asht në të vërtetë shovinizma e kujdo kombi”³⁴.

Për organizimin e brendshëm të Ballit Kombëtar është e vështirë të gjykosim, pasi dokumentacioni për këtë organizatë është shumë i pakët. Nga një udhëzues që gjendet të Arkivin Qendror të Shtetit, por që nuk ka as firmë, as datë dhe asnjë mjet për të përcaktuar nëse është dokument autentik, mund të kuptojmë këtë lloj organizimi të Ballit: Themeli i

³¹ AQSH, F. 270/APL, V. 1943, D. 11, fl. 4, Dekalogu i Ballit Kombëtar, 1942.

³² *Po aty*, F. 270/APL, V. 1943, D. 1, fl. 1, Udhëzim për sjelljen e anëtarësisë së Ballit Kombëtar, pa datë.

³³ *Po aty*.

³⁴ *Po aty*.

organizatës është *vatra* e përbërë prej 5 vetave, në të cilën ka një kryetar që zgjidhet në mënyrë demokratike nga të gjithë anëtarët e saj. Në qytete që ka më shumë se 1 vatër, organizohet një qarkore, e cila koordinon veprimet. Në fshatra ku nuk mund të ketë vatra, krijohen “këshillat e katundeve”³⁵. Duket se Balli ka “kopjuar” modelin organizativ të PKSH/FNÇ (celula, komiteti qarkor dhe këshillat nacionalçlirimtare), por, në dallim nga kjo, BK ishte tërësisht një strukturë heterogjene. Dhe heterogjeniteti i tij, lidhet si me përbërjen, me pikëpamjet e tyre politike, por edhe me qëndrimin që ata mbajtën ndaj luftës, veçanërisht gjatë pushtimit italian të Shqipërisë. Ajo çfarë i bashkonte anëtarët e BK ishte republikanizmi, nacionalizmi dhe antikomunizmi. Heterogjeniteti në pikëpamje u përkthye edhe në qëndrime të ndryshme të Ballit Kombëtar ndaj pushtuesit, ku do të dalloja tri rryma.

E para, ishte një rrymë pragmatiste, e cila nuk e anashkalonte bashkëpunimin me pushtuesin. Në të vërtetë këtë nuk e ndalonte edhe vija politike e organizatës. Sipas udhëzuesit të sipërpërmendur, një anëtari të Ballit nuk i lejohej të përfshihej në administratën e pushtuesit fashist, por sqaronte se “themi se një element inkuadrohet në sistemin fashist çdo herë që ai element sillet në mënyrë që fashizmi të mund të ketë ndonjë përfitim prej asaj sjelljeje”.

Rryma *e dytë* e BK-së ishte ajo që mbajti një qëndrim pritës ndaj luftës. Përfaqësuesit e kësaj rryme, njerëz me një karrierë të gjatë politike, mendonin që duhej të ruhej popullsia nga reprezaljet e armikut e të mbrohej pasuria kombëtare. Një qasje të tillë në kushtet e luftës, do të gjykohej si jo realiste dhe e dëmshme.

Rryma *e tretë*, ishte rryma revolucionare e Ballit, e cila u angazhua menjëherë në lëvizjen kundër pushtuesit. Krijoi çetat vullnetare dhe ndërmori jo pak aksione të armatosura kundër pushtuesit italian veçanërisht në krahinën e Vlorës, Korçës, Beratit dhe Kolonjës.

Marrëdhëniet ndërmjet Frontit Nacionalçlirimtar dhe Ballit Kombëtar në periudhën janar-korrik 1943

Si PKSH/FNÇ, ashtu dhe Balli Kombëtar, kishin para vetes një sfidë të madhe për t’u përballur: sigurimi i mbështetjes së shqiptarëve, si premisë e nevojshme për suksesin e programeve të tyre politike. Për të dyja palët kjo ishte një nevojë urgjente si për planet afatgjata të tyre,

³⁵ *Po aty*, fl. 2.

ashtu dhe për organizimin e rezistencës. Në këtë proces, të dyja formacionet kishin përparësitë dhe mangësitë e veta.

PKSH kishte në favor të saj faktorin kohë dhe modelin organizativ. Si një parti e krijuar më 1941, ajo kishte pasur më shumë kohë për t'u marrë me organizimin e strukturave të saj. Shpalosja e idesë së Frontit Nacionalçlirimtar kishte tërhequr në krah të saj disa nga nacionalistët dhe zogistët me peshë, sidomos në Shqipërinë e Veriut, ku ajo e kishte vështirë të hynte. E ndërtuar si parti solide dhe me disiplinë të hekurt, PKSH kishte ndërtuar një sistem të centralizuar vendimmarrjeje, e cila e bënte organizatën të fortë. Për PKSH përparësi ishte dhe përbërja e saj moshore. Si drejtuesit, anëtarësia dhe simpatizantët e PKSH kishin moshë relativisht të re. Kjo bënte që idealizmi, mobilizimi, entuziazmi dhe guximi për aksione të ishte më i madh. Për më tepër, kjo krijonte kushte për të tërhequr atë pjesë të shoqërisë e cila ishte e zhgënjyer ndaj politikës dhe elitës tradicionale shqiptare. PKSH kishte dhe përparësinë e shtresëzimit social. Pjesa më e madhe e drejtuesve dhe e anëtarësisë i përkisnin shtresës së mesme dhe të varfër. Moslidhja e tyre me pronën i bënte ata më të dëshiruar/më të papërmbytur për aksione.

Disavantazhi më i rëndësishëm për PKSH ishte ideologjia ku ajo mbështetej, e cila ishte e pakuptueshme për një masë jo të vogël shqiptarësh. Kjo u pasqyrua në vështirësinë që patën komunistët të depërtonin në zonat rurale të Shqipërisë³⁶. Në mënyrë disi paradoksale, përparësitë e sipërpërmendura krijuan edhe disa vështirësi, të cilat PKSH ishte e detyruar t'i tejkalonte. Si një parti e njerëzve të rinj në politikë, në një shoqëri ku tradita e të moshuarve ishte mjaft e konsoliduar, PKSH pati mjaft vështirësi të shtrinte ndikimin, veçanërisht në disa zona ku doket dhe zakonet tradicionale ishin më të fuqishme. Në të njëjtën mënyrë, zelli i madh për aksione jo gjithmonë pritej mirë nga populli. Aksionet e çetave partizane shpesh pasoheshin nga reprezalje të rënda prej pushtuesve italianë, të cilat do të thoshin shkatërrime të pronës së popullsisë civile, por edhe humbje të jetëve dhe burgosje e internime të tyre. Pas aksionit të çetës së Mallakastrës, të drejtuar nga Mehmet Shehu, ndaj minierës së Selenicës në janar 1943, ushtria italiane ndërmoi një fushatë intensive reprezaljesh ndaj popullsisë vendase, tek e cila u

³⁶ Në Konferencën I të PKSH (mars 1943) mosshtrirja sa duhet në zonat rurale u konsiderua si një nga mangësitë më të mëdha të PKSH. *Shih. Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 10, Nga procesverbali i Konferencës I të PKSH, mars 1943.

shkaktua një pakënaqësi e fortë ndaj çetës partizane. Për këtë arsye, Gjin Marku, atëherë anëtar i KQ të përkohshëm dhe i dërguari i këtij komiteti në zonën e Beratit, i shkroi një letër Mehmet Shehut në të cilën, pasi e përgëzonte për iniciativën për aksione, i tërhiqte vëmendjen: “natyrisht aksioni efektivisht duhet të bëhet me popullin kur luftojmë si popull, me klasën kur luftojmë si klasë ose në mos efektivisht të paktën politikisht të jetë pranuar nga populli apo nga klasa ose tek e mbramja të ketë mundësi pak ma vonë të quhet i pranushëm dhe i drejtë aksioni; pra me një fjalë aksioni të bëhet i pjekur”³⁷.

PKSH u tregua e shkathët për t’i tejkaluar këto vështirësi. Ndërsa, fillimisht, në fazën e organizimit të saj, ajo u mbështet në ndihmën e njerëzve me ndikim në krahina të ndryshme, si te Mestan Ujaniku në Skrapar, Myslim Peza në Tiranë, Baba Fejzoja në Tepelenë, Mustafa Xhani në Martanesh, Tele Baçi në Korçë etj., më pas iu dha rëndësi organizimit të strukturave ushtarake jo mbi baza territoriale. Si pasojë shtresëzimi politik, social, moshor dhe gjinor u bë i rëndësishëm për suksesin dhe sigurimin e mbështetjes në popull, ndërsa ndikimi individual kaloi gjithnjë e më shumë në plan të dytë.

Balli Kombëtar kishte përparësinë se mbështetej te nacionalizmi, një ideologji politike shumë e njohur dhe e pranuar prej shqiptarëve. Një tjetër element favorizues për Ballin ishte ndikimi që kishin personalitetet drejtuese të tij te krerët e krahinave. Përkundër vështirësive fillestare që kishte kaluar PKSH për të gjetur mbështetjen e popullsisë për të ngritur dhe organizuar njësitë luftarake dhe këshillat nacionalçlirimtarë, Balli Kombëtar pati më shumë sukses në një kohë më të shkurtër në këtë drejtim. Ai shfrytëzoi ndikimin që kishin anëtarët e Ballit Kombëtar në krahina të caktuara dhe u mbështet në këtë ndikim për të ngritur çetat luftarake dhe këshilla të fshatrave apo krahinorë, madje duke prishur në ndonjë rast edhe këshillat nacionalçlirimtarë, të cilat ishin krijuar me shumë mund nga aktivistët lokalë të PKSH dhe FNÇ. Sipas fjalës së Bedri Spahiut në Konferencën e Parë të PKSH (mars 1943), Balli ishte bërë shkaktar për prishjen e disa këshillave në fshatrat e qarkut të Gjirokastrës, madje dhe këshillin nacionalçlirimtar të qytetit³⁸. Balli

³⁷ *AQSH*, F. 18/APL, V. 1943, D. 6, fl. 1, Letër e Gjin Markut për Mehmet Shehun mbi marrëdhëniet me Ballin Kombëtar, pa datë.

³⁸ *Po aty*, F. 17/APL, V. 1943, D. 9, fl. 2, Raport i Çakallit (Dilaver Poçi) për komitetin qarkor të PKSH për Gjirokastrën, 20 shkurt 1943; *AQSH*, F. 14/APL, V. 1943, D. 10, fl. 32, Nga diskutimi i Bedri Spahiut në Konferencën I të PKSH, mars 1943.

Kombëtar mund të mbështetej dhe në tolerancën e heshtur të autoriteteve italiane të pushtimit. Propaganda nacionaliste e Ballit nuk binte ndesh me qëllimet e politikës italiane për të nxitur irredentizmin e shqiptarëve, ndërsa antikomunizmi i Ballit u shërbente shumë mirë interesave të pushtuesit. Kështu autoritetet e pushtimit toleronin aktivitetin propagandues të Fazlli Frashërit, Ali Këlcyrës etj., për sa kohë që ai nuk shoqërohej me veprimtari kundër autoriteteve italiane³⁹.

Në të ardhmen, u pa qartë se të dy palët ia njihnin mirë si dobësitë dhe pikat e forta njëra-tjetrës dhe u përpoqën t'i shfrytëzonin secili për interesin e vet, por në fillim të vitit 1943 të dyja palët ende kishin nevojë për njëra-tjetrën dhe duhej të gjenin mënyrën për të bashkëpunuar. Të dyja organizatat, si Fronti Nacionalçlirimtar, ashtu dhe Balli Kombëtar, kishin të njëjtën zonë veprimi dhe mbështetjeje, kryesisht Shqipërinë e Jugut dhe më pak në atë të Mesme. Të dyja organizatat mbështeteshin mbi të njëjtat burime financimi: ndihmat e popullsisë (financime, ushqime, strehë etj.), si dhe sulmet ndaj depove të armikut. Sa i takon raportit të forcave ushtarake mes tyre, nëse u referohemi të dhënave të raporteve britanike të muajve prill-maj 1943, ai duket se anonte disi nga çetat e organizuara nën siglën e Lëvizjes Nacionalçlirimtare⁴⁰, por gjithsesi kishte një ekuilibër mjaft të qëndrueshëm. Ndërkohë që raporti komunistë-nacionalistë anonte dukshëm nga këta të fundit, kjo për shkak të përfshirjes në njësitë e organizuara nën siglën e Frontin Nacionalçlirimtar dhe të mjaft jokomunistëve si Mestan Ujaniku, Abaz Kupi, Mustafa Xhani (Baba Faja Martaneshi), Myslim Peza, Haxhi Lleshi e të tjerë. Kjo situatë e balancuar e bënte të domosdoshme, për të dyja palët, gjetjen e një rruge për të arritur një marrëveshje bashkëpunimi, gjë që rezultoi shumë e vështirë.

Sa i takon klimës së marrëdhënieve ndërmjet FNÇ dhe Ballit Kombëtar në gjysmën e parë të vitit 1943 ajo ndryshonte nga qarku në qark dhe në këto marrëdhënie ndikonte mbështetja që kishin grupimet në

³⁹ *Shënime për Shqipërinë, dokumente historike italiane nga Arkivi Shtetëror italian, prill-korrik 1943*, përgatitur për botim nga Bejtullah Destani dhe Ethem Çeku, Londër: Qendra për Studime Shqiptare, 2015, f. 109, Lajmet e datës 29 prill 1943. Dokumenti njofton se “Ali Këlcyra, person i njohur tashmë, dje më datë 27 të këtij muaji foli para popullit të Libohovës duke e ftuar që të bashkëpunojë me autoritetet dhe që t'i luftojë komunistët. Do të mbajë një fjalim me të njëjtin qëllim më datë 28 të këtij muaji në Picar dhe në 29 në Tepelenë”.

⁴⁰ M. Dezhgiu, *Shqipëria nën pushtimin italian ...*, f. 271.

secilin qark, por edhe këndvështrimet e drejtuesve. Në zonën e Vlorës dhe Gjirokastrës, ku të dyja organizatat kishin mbështetës të shumtë dhe ndiheshin të fuqishme, përplasjet ishin më të shumta dhe më të hershme. Në ditët e para të shkurtit 1943, një incident që mund të përfundonte në përleshje mes dy grupimeve ndodhi në Fushë-Bardhë të Gjirokastrës mes çetës partizane të komanduar nga Dilaver Poçi dhe asaj të Ballit Kombëtar të drejtuar nga Jonuz Topulli. Të dyja çetat ishin ngarkuar me detyrën e propagandimit të organizatave përkatëse në atë zonë. Jonuz Topulli, sipas relacionit që çeta i dërgonte qarkorit të Gjirokastrës, ishte takuar me çetën në Fushë-Bardhë të Gjirokastrës, një fshat që mbështeste Frontin. Populli i kishte hedhur romuze Jonuz Topullit në prani të çetës partizane dhe, ky në shenjë hakmarrjeje e kishte ndaluar çetën të kalonte nëpër fshatrat ku ai kishte ndikim, madje duke e kërcënuar se do të hapte zjarr. Incidenti kishte përfunduar me kaq, sepse çeta partizane ishte tërhequr⁴¹. Komiteti qarkor i Gjirokastrës, sapo kishte marrë vesh këtë incident, madje dhe pa pritur sqarimet e komandantit të çetës partizane, dërgoi një urdhër për të gjitha çetat partizane në krahinë, në të cilin ndër të tjera kërkohet të evitohet një përpjekje me të, “por në rast se Jonuzi ju bën ndonjë pritë dhe kjo vërtetohet, atëherë çetat të marrin qëndrim të prerë duke u sjellur kundra tij e njerëzve të tij sikurse kundra armikut”, por gjithmonë duke porositur që çeta e Ballit të ishte e para që hapte zjarr⁴². Ngjarja u shoqërua me trakte dhe kundërtrakte nga të dyja palët dhe bëri shumë bujë në të gjithë qarkun. Por, ky nuk ishte veçse një incident i kryer në gjaknxehtësi e sipër nga një person. Këtë e kishin kuptuar edhe drejtuesit komunistë të qarkut, sepse Bedri Spahiu në një letër që i shkruante KQ të PKSH, vinte në dukje se krerët e Ballit në qark nuk e kishin parë me sy të mirë veprimin e J. Topullit dhe se ky e kishte bërë ose me iniciativën e tij, ose i shtytur nga fashizmi⁴³.

Një tjetër panoramë e marrëdhënieve mes FNC dhe Ballit Kombëtar na shfaqet në qarkun e Beratit në fillim të vitit 1943. Marrëdhëniet e çetave partizane të kësaj krahine me Abaz Ermenjin duket të kenë qenë mjaft bashkëpunuese, madje flitet dhe për krijimin e

⁴¹ AQSH, F. 17/APL, V. 1943, D. 9, fl. 2, Raport i Çakallit (Dilaver Poçi) për komitetin qarkor të PKSH për Gjirokastrën, 20 shkurt 1943.

⁴² Po aty, F. 17/APL, V. 1943, D. 2, fl. 3, Qarkore e qarkorit të PKSH për Gjirokastrën për çetat partizane në krahinë, 15 shkurt 1943.

⁴³ Po aty, F. 17/APL, V. 1943, D. 3, fl. 1, Letër e Kaçiatorit (Bedri Spahiu) për KQ të PKSH, 18 shkurt 1943.

një “komisioni luftime”. Ermenji dëshmon me anë të një letre se ai, së bashku me Gjin Markun dhe dy të tjerë kishin shkuar në një takim me prefektin e Beratit për ta detyruar atë të largonte nga qyteti forcat e Milicisë Fashiste të Dod Nikollës⁴⁴. Pavarësisht kësaj, ky bashkëpunim i ngushtë nuk ishte pritur mirë nga të gjithë komunistët e zonës. Ata ankoheshin për sjellje brutale të Abaz Ermenjit ndaj partizanëve⁴⁵ dhe, për më tepër nuk e kishin përtypur mirë vendosjen e tij si komandant ushtarak të krahinave të Kapinovës dhe Perisnakës duke i bashkuar të gjitha forcat e krahinës nën komandën e tij⁴⁶.

Ndërsa në nivel lokal situata ishte jo e unifikuar, drejtuesit qendrorë kishin shfaqur dëshirën e tyre për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin. Në korrik 1943, në referatin e mbajtur në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm NÇ të Labinotit, Enver Hoxha pohon se ishin bërë përpjekje për ta ftuar Ballin Kombëtar t’i bashkohej frontit të krijuar në Pezë si një organizatë. Ai shprehet se në dhjetor 1942 ishin dërguar tre përfaqësues të Këshillit për të folur me një nga krerët e Ballit⁴⁷. Këtë e pohon dhe Bahri Omari, i cili ishte ngarkuar nga Mithat Frashëri për t’u takuar me përfaqësuesit e PKSH⁴⁸. Bisedimet ngecën pikërisht në modalitetet e arritjes së këtij bashkëpunimi. PKSH, pas direktivave të Kominternit, kërkonte ta përfshinte Ballin si organizatë në Frontin Nacionalçlirimtar, të ngritur sipas vendimeve të Konferencës së Pezës. Balli, nga ana e tij, nuk e njihte Konferencën e Pezës dhe nuk e konsideronte Këshillin e Përgjithshëm Nacionalçlirimtar dhe gjithë strukturën organizative që ishte krijuar në bazë të tij si një front popullor. Për të, në Shqipëri

⁴⁴ *Po aty*, F. 19/APL, V. 1943, D. 4, fl. 3, Letër e Abaz Ermenjit për komandën e qendrës Skrapar, 16 janar 1943.

⁴⁵ M. Dezhgiu, *Shqipëria nën pushtimin ...*, f. 261; *AQSH*, F. 19/APL, V. 1943, D. 4, fl. 4-5, Letër e partizanëve dhe vullnetarëve të disa fshatrave, si dhe Avni Kapinovës për komisionin e luftës, Vërzhezhë, 16 janar 1943.

⁴⁶ *AQSH*, F. 19/APL, V. 1943, D. 2, fl. 1, Raport i nënshkruar nga Tomori (Ali Shehu) për komitetin qarkor të Beratit, 1 shkurt 1943.

⁴⁷ *Po aty*, F. 40/APL, V. 1943, D. 3, fl. 9, Referati i Enver Hoxhës në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar të Labinotit, 4 korrik 1943.

⁴⁸ *AMPB*, F. i dosjeve hetimore dhe gjyqësore, V. 1945, D. 1568, Nga deponimi i Bahri Omarit në Gjyqin Special, 10 mars 1945. B. Omari rrëfen ndër të tjera se takimi është zhvilluar në shtëpinë e Ramazan Jaranit me kërkesën e Mithat Frashërit. Në takim, përveç tij ishin dhe Halil Maçi e Ali Begeja si përfaqësues të Ballit Kombëtar, ndërsa Fronti përfaqësohej me Enver Hoxhën, Mustafa Gjinishin dhe Ymer Dishnicën. Takimi nuk arriti ndonjë rezultat, pasi përfaqësuesit e Ballit nuk pranuan t’i njihnin bashkëbiseduesit si përfaqësues të Frontit Nacionalçlirimtar, por vetëm të PKSH.

ekzistonte vetëm PKSHE dhe Balli Kombëtar dhe, nëse do të arrihej një bashkëpunim, ky do ishte në baza dualiste. Të gjitha propozimet e bëra nga PKSHE për të përfshirë Ballin në Frontin Nacionalçlirimtar, qoftë dhe duke e rimodeluar atë, hasën në kundërshtimin e krerëve nacionalistë⁴⁹.

Në këtë kontekst, në fillim të vitit 1943, Balli Kombëtar propozoi të fillohej me bashkëpunimin e dy organizatave në nivel lokal duke u bërë, kështu, nxitësi i krijimit të komiteteve të koordinimit në nivel lokal. Nga dokumentacioni i shfletuar të krijohet bindja se marrëveshja është arritur nga drejtuesit e lartë të këtyre organizatave, pavarësisht se zbatimi i saj do të bëhej në nivel lokal. Kështu, në një letër që Enver Hoxha i dërgon komitetit qarkor të PKSHE për Gjirokastrën shkruan: “Këta [Balli Kombëtar] propozonin që Balli dhe PK të formonin një komision miks në çdo qytet dhe gjithsecili të bënte punën. Kjo punë është një minimum i vogël fare, i përshtatshëm vetëm për ata që s’e kanë marrë me zemër këtë çështje. Me gjithë përpjekjet e partisë për një bashkim të gjerë dhe të shëndoshë, ata s’e lëshonin aspak brezin, prandaj u përfundua kështu që ne kemi një lidhje me Ballin. Në çdo qytet do të ketë nga një *komision për koordinim aksioni* [nënvizimi im-S.B.] i përbërë prej një shok nga tanët dhe një prej të atyre. Ky komision ka këto të drejta: njëra palë propozon të bëhet ndonjë aksion ku duhet të bashkohen që të dyja palët, në qoftë se aksioni pranohet aherë veprohet, në rastin e kundërt pala që e propozon aksionin e kryen vetë. Aspak s’jemi të detyruar me i pyet për kryerjen e ndonjë aksioni që ne na duket i nevojshëm dhe konspirativ. Nga ana tjetër, ky komision duhet të përpiqet me zbut mosmarrëveshjet që mund të ngjasin dhe me i bind të Ballit të marrin pjesë aktive në luftë”⁵⁰.

Pa u zgjatur mbi aktivitetin e këtyre komiteteve, pasi për to është shkruar⁵¹, mendoj se është vendi për disa observime:

Së pari, marrëveshjet nuk ishin detyruese nga pikëpamja e detyrave dhe detyrimeve të palëve ndaj njëra-tjetrës. Sipas tyre, palët mund të propozonin për një aksion kundër pushtuesve italianë, por, nëse nuk binin dakord, ato mund ta kryenin edhe të vetme aksionin. Nga ana tjetër, ato

⁴⁹ AQSH, F. 17/APL, V. 1943, D. 1, fl. 1, Letër e Enver Hoxhës për komitetin qarkor të PKSHE për Gjirokastrën, 23 shkurt 1943.

⁵⁰ Po aty.

⁵¹ Për më tepër shih: M. Dezhgiu, *Shqipëria në pushtimin ...*, f. 262-266; P. Milo, *Shqipëria në Luftë ...*, f. 295-297; U. Butka, *Lufta civile në Shqipëri ...*, f. 15-16.

nuk kishin detyrimin për të njoftuar domosdoshmërisht palën tjetër për aksionet që kishin ndërmend të kryenin.

Së dyti, dukej qartë se palët nuk e besonin njëra-tjetrën, apo hynin në këtë marrëveshje jo shumë të bindura. Enver Hoxha i tërheq vëmendjen varësve të vet se “kjo lidhje [marrëveshja] është qepur me pe të bardhë dhe pengesa do të hasim mjaft në rrugën tonë, të cilat nuk duhet të na alarmojnë as të humbasim gjakftohtësinë, as të lëmë të shkelet dinjiteti i partisë, qoftë dhe një qime dhe as të vihen gurrë në rrotat e luftës nacionalçlirimtare”⁵².

Marrëveshja nuk e pengoi Hoxhën edhe të mendonte për ta dëmtuar nga brenda Ballin si organizatë. Në shkurt-mars 1943, grupi komunist “Zjarri” pranon të shkrihet plotësisht me PKSH⁵³. Drejtuesit e PKSH kërkonin t’i shfrytëzonin zjarristët, që ishin anëtarësuar në Ballin Kombëtar, për të punuar si fraksion i PKSH brenda organizatës, për ta unifikuar atë me linjën e Frontit Nacionalçlirimtar. Ideja e Hoxhës ishte që ky grup do të punonte nga brenda organizatës për t’i bindur krerët dhe anëtarët që “të pranojnë një bashkëpunim të ngushtë me Partinë, të pranojnë të marrin pjesë në Këshillat Nacionalçlirimtare”⁵⁴. Mosbesimi ishte i dyanshëm, pasi edhe Balli Kombëtar kishte vënë si kusht që marrëveshja e arritur për komisionet e koordinimit të mos bëhej publike.

Së treti, ndodhte shpesh që një aksion i filluar së bashku të lihej në mes nga njëra apo tjetra palë, duke i krijuar vështirësi të mëdha njëra-tjetrës për të përballuar forcat e armikut. Kështu, Balli akuzonte çetat e Frontit se ishin tërhequr disa herë nga luftimet duke i lënë në vështirësi forcat e tyre, siç kishte ndodhur në Gjorm (dhjetor 1942), Selenicë (mars 1943) etj.⁵⁵. Edhe komandantët e çetave partizane ankoheshin që forcat e Ballit tërhiqeshin në mes të luftimeve duke krijuar vështirësi për ta. Kështu, Xhelal Staravecka dëshmon se, pasi kishin rënë dakord me Kadri Cakranin të bënin një aksion të përbashkët kundër forcave të Isa Toskës,

⁵² AQSH, F. 17/APL, V. 1943, D. 1, fl. 2, Letër e Enver Hoxhës për komitetin qarkor të PKSH për Gjirokastrën, 23 shkurt 1943.

⁵³ P. Milo, *Shqipëria në Luftën ...*, f. 311.

⁵⁴ AQSH, F. 20/APL, V. 1943, D. 2, fl. 10, Letër e Semanit (Enver Hoxhës) për komitetin qarkor të PKSH për Korçën në lidhje me punën me grupin fraksionist “Zjarri”, mars 1943; P. Milo, *Shqipëria në Luftën ...*, f. 311.

⁵⁵ Faik Quku, *Qëndresa shqiptare gjatë Luftës ...*, f. 223.

ky i fundit ishte tërhequr në kulm të luftimeve duke ia lënë gjithë barrën çetave partizane⁵⁶.

Së katërti, duke qenë se këto marrëveshje nuk kishin karakter detyrues, secila nga palët ishte e lirë të ndiqte qëllimet e saj politike. Kështu, drejtuesit e PKSH porosisnin strukturat e veta që të vijonin punën për ngritjen e këshillave nacionalçlirimtarë në të gjitha krahinat në bazë të frymës së Pezës dhe të vijonin përpjekjet për të tërhequr sa më shumë elementë nga Balli dhe për t'i bindur ata për t'iu bashkuar Frontit. Ndërkohë marrëveshjet nuk i pengonin krerët e Ballit të kërkonin edhe marrëveshje paralele, qoftë edhe me autoritetet ushtarake italiane, siç ishte rasti i marrëveshjes të papërfunduar ndërmjet gjeneralit italian Renzo Dalmazzo dhe Ali Këlcyrës dhe Nuredin Vlorës⁵⁷, apo kërkesa e Safet Butkës drejtuar nënprefektit të Kolonjës⁵⁸.

Pavarësisht, problemeve dhe kontradiktave që lidheshin me këndvështrimet e ndryshme të karakterit politik, si: e ardhmja e organizimit politik dhe shoqëror në Shqipërinë e Pasluftës, aleanca e PKSH/FNÇ me PKJ, mosdeklarimi i hapur nga ana e komunistëve për qëndrimin e saj në lidhje me çështjen kombëtare etj., mund të themi se deri në gusht të vitit 1943, palët toleruan në mënyrë të kujdesshme njëra-tjetrën, duke i kufizuar kundërshtitë e tyre kryesisht në lëmin propagandistik. Por, nuk munguan edhe incidentet. Në fillim të majit forcat e Safet Butkës kishin shkuar në fshatin Vodice të Kolonjës për të arrestuar Josif Pashkon, i cili kishte qenë kreu i një gjyqi partizan ku

⁵⁶ *AQSH*, F. 19/APL, V. 1943, D. 2, fl. 5/1, Raport i Xhelal Staraveckës dhe Beqir Zaloshnjës, përkatësisht komisar dhe komandant i çetës së Skraparit për komitetit qarkor të Beratit, 20 mars 1943.

⁵⁷ Për më tepër *shih*: Ali Këlcyra, *Shkrime për Historinë e Shqipërisë*, përgatitur për botim nga Tanush Frashëri, Tiranë: Onufri, 2012, f. 203-208.

⁵⁸ Më 20 maj 1943, Safet Butka, me cilësinë e kreut të çetave të Ballit Kombëtar për zonën e Kolonjës dhe Leskovikut i ankohet nënprefektit të Kolonjës për faktin se trupat italiane nuk bëjnë dallim ndërmjet forcave komuniste dhe atyre nacionaliste. "Z. N/prefekt, - shkruante Butka, - ju si autoritet shqiptar e kini për detyrë t'i njoftoni komandës në fjalë atë që ju dini mirë: populli i Kolonjës është 90 e ca përqind nacionalist e kështu në kundërshtim diametral me programin e komunistave të këtij qarku. Kaq e vërtetë sa ky popull me mbështetjen tonë, komunistave jo vetëm s'u ka dhënë bukë e banesë, por i ka dëbuarë e p.sh në Vodice edhe rrethuar me armë". Për më tepër *shih*: *AQSH*, F. 152, V. 1943, D. 141, fl. 3-4, Shkresë e Zyrës Politike të Ministrisë së Brendshme për Këshillin e Ministrave, 17 qershor 1943.

ishin dënuar me vdekje katër vetë, me sa duket nacionalistë⁵⁹. Situata nuk shkoi deri në konfrontim të armatosur, por ndikoi në prishjen e atmosferës së bashkëpunimit. Më 12 qershor 1943, forcat partizane arrestuan Ali Këlcyrën, ndërsa ky po udhëtonte me autobusin e shoqërisë SATA nga Gjirokastra për në Tiranë⁶⁰, incident që shkaktoi një situatë të pakëndshme ndërmjet dy organizatave në Gjirokastër, por që përfundoi pa u thelluar. Incidente të tilla ishin të karakterit individual dhe nuk pasqyronin linjën politike të grupimeve përkatëse. Madje, ato u kritikuan nga drejtuesit⁶¹. Si në Korçë, ashtu edhe në Gjirokastër, linja politike ishte e përcaktuar: nuk duhet të krijoheshin incidente me Ballin dhe duhej gjetur mënyra për t'i rregulluar punët. Balli gjithashtu nuk dëshironte t'i përkeqësonte marrëdhëniet në mënyrë që të bëhej shkaktar i fillimit të vëllavrasjes⁶².

Korriku i vitit 1943 i gjeti të dyja grupimet në pozicionet e tyre dhe marrëdhëniet larg të qenit bashkëpunuese. Ndërsa, PKSH shfaqej më e organizuar dhe FNÇ më i fuqishëm se një vit më parë, pak gjëra kishin ndryshuar për Ballin Kombëtar⁶³. Situata ndryshoi nga fundi i verës së vitit 1943. Më 25 qershor 1943, në një mbledhje paraprake të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar të mbajtur në Labinot, Abaz Kupi propozoi për të arritur një marrëveshje me Ballin për t'u bashkuar në luftën kundër okupatorit⁶⁴. Disa ditë më vonë, më 9 korrik 1943 gjatë zhvillimit të punimeve të mbledhjes së Këshillit të Përgjithshëm

⁵⁹ *Po aty*, F. 152, V. 1943, D. 121, fl. 1, Njoftim i Prefekturës së Korçës për Ministrinë e Brendshme, 4 maj 1943; *AQSH*, F. 20/APL, V. 1943, D. 4, fl. 14-15, Letër e Plakut (Pëllumb Dishnicës) për KQ të PKSH, pa datë.

⁶⁰ Për më tepër *shih*: A. Këlcyra, *Shkrime për Historinë e Shqipërisë ...*, f. 224-225.

⁶¹ *AQSH*, F. 17/APL, V. 1943, D. 2, fl. 8, Letër e Laskos (Haki Toska) për qarkorin e PKSH për Gjirokastrën në lidhje me arrestimin e Ali Këlcyrës, 16 qershor 1943.

⁶² *Po aty*, F. 20/APL, V. 1943, D. 4, fl. 14-15, Letër e Plakut (Pëllumb Dishnicës) për KQ të PKSH, pa datë. Dishnica ndër të tjera përmend se “Rrethimi i Vodicës qe një humbje për Safetin, dhe aty këtu dukeshin shenja se krerët e Ballit kërkonin t'afroheshin për të bërë një bashkim”.

⁶³ Që në prill 1943, PKSH u kishte dhënë udhëzime strukturave të veta të kalonin nga çeta territoriale, në formacione më të mëdha si: çetat ndërterritoriale dhe batalione. Më 20 qershor 1943 filluan përgatitjet për organizimin e Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe u dha udhëzimi për krijimin e brigadave të para partizane. Pra, FNÇ po kalonte në strukturimin e ushtrisë partizane, duke pasur edhe ndihmën e të dërguarve jugosllavë dhe të misionarëve britanikë për këtë. Ndërkohë, Balli Kombëtar kishte mbetur ende në fazën e organizimit ushtarak të çetave territoriale.

⁶⁴ M. Dezhgiu, *Shqipëria nën pushtimin ...*, f. 262-266.

Nacionalçlirimtar, e cila vendosi dhe krijimin e Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe të Shtabit të Përgjithshëm të saj, u caktuan edhe përfaqësuesit e Frontit që do të zhvillonin bisedime me Ballin, por pa përcaktuar detaje mbi këto bisedime. Ata ishin Abaz Kupi, Myslim Peza, Ymer Dishnica dhe Mustafa Gjinishi. Përpjekjet e tyre rezultuan të suksesshme dhe më 25 korrik në Tapizë, në shtëpinë e Ihsan Toptanit, përfaqësuesit e të dy grupeve takohen dhe përpilojnë një projekt-marrëveshje. Disa ditë më vonë, marrëveshja finalizohet në Mukje, tashmë me një përfaqësi më të gjerë nga të dyja palët⁶⁵.

Marrëveshja e Mukjes ishte padyshim një fitore për Ballin Kombëtar. Ajo përmbante tri nga pikat për të cilat Balli ishte përpjekur gjatë: një organizatë dualiste (Komiteti i Shpëtimit të Shqipërisë), ku Balli dhe Fronti të konsideroheshin të barabartë; e kishte bërë PKSHE të shprehej për çështjen kombëtare (Shqipëria etnike); e kishte bërë PKSHE të pranonte idenë e ndarjes së pushtetit në të ardhmen (marrëveshja flet për demokraci të vërtetë dhe jo popullore, siç propagandon PKSHE). PKSHE fitoi nga kjo marrëveshje daljen nga pozita pritëse e Ballit dhe premtimin e tij për të luftuar kundër okupatorit të tanishëm dhe çdo okupatori tjetër.

Ndryshimet e pritshme në situatën ndërkombëtare do të kishin ndikimin e tyre edhe në Shqipëri. Zbarkimi i Aleatëve në Sicili, grushti i shtetit të Badoglios dhe, veçanërisht, Marrëveshja e Mukjes ishte një moment i fortë kthese në marrëdhëniet ndërmjet Ballit Kombëtar dhe PKSHE/FNÇ. Për një moment të shkurtër gjatë gushtit të vitit 1943, u duk sikur pushtimit po i vinte fundi për Shqipërinë dhe palët duhet të ishin më të përgatitura për pushtetin e Pasluftës. Situata ishte kaotike për të dyja palët. Enver Hoxha, edhe nën ndikimin e të dërguarve jugosllavë, reagoi menjëherë duke hedhur poshtë të gjitha pikat e marrëveshjes së arritur në Mukje, duke krijuar një rritje të tensionit mes FNÇ dhe Ballit Kombëtar⁶⁶.

Shpallja e kapitullimit të Italisë krijoi problemin e zotërimit të materialit ushtarak të njërive ushtarake. Nga njëra anë qëndronin komandantët ushtarakë italianë, të cilët nuk kishin udhëzime nga drejtuesit e tyre se kujt do t'i dorëzoheshin dhe, nga ana tjetër, rivaliteti i

⁶⁵ Për më tepër për Marrëveshjen e Mukjes shih: M. Dezhgiu, *Shqipëria nën pushtimin ...* f. 280-326.

⁶⁶ Mbi rolin e jugosllavëve në prishjen e Marrëveshjes së Mukjes shih: A. Lalaj, *Dosjet e luftës ...*, f. 59-61.

të dyja grupimeve, të cilat nxitonin për të përfituar sa më shumë armatime nga pushtuesit e mundur. Ky është momenti i parë që të dyja grupimet u vendosën zyrtarisht përballë njëra-tjetrës. Porosia që drejtuesit lokalë të PKSHE marrin nga qendra e tyre është që të kontrolloheshin me kujdes lëvizjet e Ballit, në mënyrë që ai të “mos bëjë ndonjë kompromis me ushtrinë italiane”⁶⁷. Situata u ndoq nga afër edhe nga ushtarakët britanikë, të cilët mbështesnin njërin apo tjetrin grupim. Kështu, p.sh. drejtuesit e PKSHE në zonën e Vlorës ankoheshin se “Majori Ingles s’donte të armatoseshim duke çarmatosur ushtrinë Italiane. Për këtë punë ai na drejtonte letra me kërcënime, mirëpo kjo politikë nuk i shkoi mbasi i dham përgjigjen e duhur”⁶⁸. Ndërsa në Dibër, majori britanik Seymore kishte favorizuar forcat e UNÇ të Haxhi Lleshit kundër krerëve nacionalistë të Dibrës⁶⁹.

Për drejtuesit komunistë duket se koha e propagandës kishte mbaruar. Më 10 shtator 1943, Enver Hoxha dërgon një qarkore ku porosiste për një ndryshim të vijës politike ndaj Ballit Kombëtar. Balli duhej të nixtej për të luftuar pushtuesin, duhet të pranonte aleancën me Koalicionin e Kombeve të Bashkuara, sidomos të pranonte bashkëpunimin me luftën kundër boshtit fashist të shteteve fqinjë, Greqinë dhe Jugosllavinë; të njiheshin këshillat nacionalçlirimtarë si të vetmet “organe të pushtetit demokratik dhe të insistohet në këtë pikë”; Balli duhet të dënonte të gjithë anëtarët që kishin bashkëpunuar me fashizmin⁷⁰. Në të njëjtën letër, Hoxha udhëzon strukturat e tij që të shtojnë propagandën në popull për ta diskredituar Ballin, në mënyrë që ai ta konsideronte atë (Ballin) shkaktar të vëllavrasjes së pashmangshme⁷¹.

Disa nga strukturat e Ballit, si duket të paduruara për të mposhtur komunistët, u bashkuan me italianët për t’i goditur ata. Kështu, në një raport të Ali Këlcyrës për Mit’hat Frashërin ai shprehet me shumë shqetësim për ngjarjet e Libohovës, ku, sipas tij, ballistët e atjeshëm me

⁶⁷ *AQSH*, F. 20/APL, V. 1943, D. 4, fl. 50, Letër e Dunavecit (Pandi Kristos) për komitetin qarkor të Korçës, 9 shtator 1943.

⁶⁸ *Po aty*, F. 18/APL, V. 1943, D. 4, fl. 3. Raport i komitetit qarkor të PKSHE për Vlorën për KQ të PKSHE.

⁶⁹ *Po aty*, F. 41/APL, V. 1943, D. 28, fl. 7, Letër e Haxhi Lleshit për Shtabin e Përgjithshëm, 13 shtator 1943.

⁷⁰ *Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 11, fl. 20, Letër e Enver Hoxhës drejtuar të gjithë komiteteve qarkore të PKSHE, 10 shtator 1943.

⁷¹ *Po aty*, fl. 21.

Nexho Bejlerin në krye ishin bashkuar me italianët kundër komunistëve “duke vrarë dhe shumë fshatarë të pafajshëm. Dërguam atje 100 veta nga fuqia që solla, - vazhdon ai, - do të vejë edhe një komision për hetime, do të formojmë edhe një gjykatore për të dënuar të komprometuarit, ish-shokët tanë”⁷².

Pushtimi gjerman i gjeti marrëdhëniet mes dy grupimeve mjaft të tensionuara. FNÇ, i organizuar tashmë në struktura më të mëdha ushtarake dhe me një Shtab të Përgjithshëm të organizuar, u mbledh në Konferencën e Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar në Labinot (4-8 shtator 1943) ku vendosi se do të vijonte luftën kundër pushtuesit, por do të mendonte edhe për pushtetin politik të së nesërme. Deklarimi i këshillave nacionalçlirimtare si të vetmet organizma të njohur lufte dhe paqeje, ishte një tregues i qartë për qëllimet afatgjata të Frontit dhe të PKSH. Kjo do të thoshte se, për FNÇ, konsideroheshin të përfshirë në rezistencën kundër pushtuesit vetëm ata që i bashkoheshin Frontit, aktorët e tjerë ishin të gjithë pa dallim reaksionarë. Duket se qëllimi i PKSH ishte të fitonte kredibilitet dhe mbështetje të masat duke marrë flamurin e rezistencës kundër pushtuesit, por për t’ia arritur kësaj duheshin defaktorizuar kundërshtarët politikë.

Në këtë moment vendimtar për fatet e Atdheut, Balli Kombëtar shfaqet i çorientuar. Arsyet mund të kërkojnë te zhgënjimi që pësoi për shkak të dështimit të Marrëveshjes së Mukjes, joshjes disi nga ideja e pavarësisë relative të propaganduar nga pushtuesit gjermanë apo edhe nga goditja që mori krahu revolucionar i Ballit, pas humbjes së Hysni Lepenicës dhe Safet Butkës. Nuk dokumentohet më që drejtuesit të orientojnë strukturat e tyre vartëse dhe secili nga ata fillon të ndjekë një politikë personale. Pikërisht në këtë kohë, më 1 tetor 1943, Enver Hoxha u dërgon të gjitha komiteteve qarkore të tij letrën në të cilën urdhëron të goditen çetat e Ballit⁷³. Nuk dihet se në cilat rrethana, por strukturave drejtuese të Ballit u ra në dorë qarkorja e 1 tetorit e PKSH, të cilën ai e bëri publike me një trakt të shpërndarë në datë 9 tetor⁷⁴. Mit’hat Frashëri i përgjigjet me dërgimin e dy qarkoreve, të dyja në datën 7 tetor 1943. Në njërin prej tyre u kërkon strukturave të Ballit në rrethe të ndalojnë

⁷² *Po aty*, F. 270/APL, V. 1943, D. 3, fl. 7, Raport nr. 3 i Ali Këlcyrës për Mit’hat Frashërin, 25 shtator 1943.

⁷³ *Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 11, fl. 35-39, Letër e Enver Hoxhës drejtuar komiteteve qarkore të PKSH, 1 tetor 1943.

⁷⁴ *Po aty*, F. 270/APL, V. 1943, D. 13, Trakt i Ballit Kombëtar, 9 tetor 1943.

përkohësisht veprimet kundër forcave gjermane⁷⁵, ndërsa në tjetrën porositi që sulmeve të komunistëve, t'u përgjigjen në të njëjtën mënyrë⁷⁶. Tipari i luftës civile i shtohet kështu rezistencës kundër pushtuesit, e cila tashmë zhvillohet aktivisht vetëm nga Fronti Nacionalçlirimtar.

Në këtë moment, FNÇ u tregua më i shkathët për të mos e ndarë rezistencën kundër pushtuesit me kundërshtarët politikë. Rezistenca e FNÇ kundër trupave nazifashiste ishte faktori kryesor që kushtëzoi mbështetjen ushtarake dhe financiare britanike dhe FNÇ u përpoq që ndihma britanike për njësitë ushtarake të tij, të ishte ekskluzive. Ndërsa krerët e Ballit përcaktuan nacionalizmin dhe antikomunizmin si themelet e politikës së tyre, por kjo ishte e pamjaftueshme për Misionet Britanike për të mbështetur Ballin. Në luftën e madhe botërore që po zhvillohej, lufta kundër ushtrisë gjermane ishte fjalëkalimi i çdo veprimi që mund të ndërmerren misionet aleate në Shqipëri. Marrëdhëniet e britanikëve me Ballin Kombëtar u përkeqësuan sidomos kur formacionet ushtarake të këtij të fundit filluan të bashkëpunonin me gjermanët, me synimin e luftës kundër komunistëve. Balli Kombëtar u transformua kështu nga një organizatë jo komuniste në antikomuniste për t'u kthyer në një grupim kolaboracionist. Ky ndryshim i politikës së Ballit shkaktoi amulli dhe brenda vetë radhëve të tij. Disa nga përfaqësuesit e krahut revolucionar të tij, si p.sh. Skënder Muço pati një lloj reflektimi për qenien e tij në këtë organizatë. Ka indikacione që ai të ketë deklaruar se do ta braktiste Ballin Kombëtar për të krijuar një parti socialdemokrate së bashku me Musinë Kokalarin⁷⁷.

FNÇ arriti t'i shfrytëzonte kujdesshëm gabimet e Ballit Kombëtar, duke e demaskuar atë gjithnjë e më shumë. Dhe, ndërsa, FNÇ vazhdonte të rriste formacionet e tij ushtarake, tregonte njëkohësisht dhe një disiplinë dhe rregulla strikte në sjelljen e partizanëve ndaj popullsisë, krerët e Ballit, duket se gjithnjë e më shumë po humbnin kontrollin e vartësve të tyre lokalë. Në këtë përplasje të vështirë midis këtyre dy grupimeve, do të fitonte ai që, në raport me situatën e krijuar, gabonte më pak. FNÇ ishte më i qartë mbi qëllimet e tij dhe mbi mjetet që do të përdorte për arritjen e tyre. Në të kundërtën, Balli u shfaq me qëllime të

⁷⁵ *Po aty*, F. 270/APL, V. 1943, D. 1, fl. 6, Qarkore nr. 6 e Mit'hat Frashërit drejtuar komiteteve krahinore të Ballit Kombëtar, 7 tetor 1943.

⁷⁶ *Po aty*, F. 270/APL, V. 1943, D. 1, fl. 7, Qarkore nr. 7 e Mit'hat Frashërit drejtuar komiteteve krahinore të Ballit Kombëtar, 7 tetor 1943.

⁷⁷ *Po aty*, F. 14/AP, V. 1943, D. 24, fl. 12-13, Letër e Gogo Nushit për Enver Hoxhën.

qarta, por jo aktiv në përpunimin e taktikave të luftës pa kompromis kundër pushtuesit. Ballit Kombëtar i mungoi nuhatja politike për të harmonizuar qëndrimet e tij me ato të Aleatëve të Mëdhenj, të cilët bashkëpunuan ngushtësisht me njëri tjetrin, pavarësisht nga orientimi ideologjik e politik i tyre. Kjo mungesë orientimi, bëri që Balli të humbte mbështetjen e Aleatëve dhe mundësinë për t'u bërë faktor politik i rëndësishëm në Shqipërinë e Pasluftës. Historiografia komuniste ka glorifikuar meritën e Enver Hoxhës dhe PKSH për fitoren kundër pushtuesit dhe marrjen e pushtetit në Shqipëri. Në një analizë, më të thellë dhe në të tjera rrethana, një "meritë" e madhe mund t'i atribuohet edhe gabimeve të kundërshtarëve të tij politikë, siç ishin edhe ato të Ballit Kombëtar.

S u m m a r y

POLITICAL GROUPS AND FEATURES OF ALBANIAN RESISTANCE AGAINST ITALIAN OCCUPATION (1942-1943)

The article deals with some issues regarding the stage of Albanian organized resistance against the Italian invaders. It analyzes the Albanian Communist Party's difficulties and the challenges to organize its inner structures; to gain the support of different groups of Albanians society and to find a way to unify the majority of Albanians into a national liberation front against the invaders. In this process, communist chiefs pursued the Comintern directives and Yugoslav model that were provided to them by the Yugoslav emissaries. Balli Kombëtar (National Front) is the other organization taken into consideration in this article. The program of the organization, its composition and all the challenges Balli has to cope with are broadly analyzed.

Relations between the Fronti Nacionalçlirimtar (National Liberation Front) and Balli Kombëtar occupied a large place in the paper. The main efforts of these organizations were to ensure the Albanians support for their own political purposes. In this process, both sides have their advantages and disadvantages. Resistance against the invaders was one of the topics of the program that should bring together both organizations, but in reality the situation was more

complex. Both groups agreed to be engaged in the resistance against invaders. However, there were differences about forms and methods for such a resistance. In spring 1943, the National Liberation Front and National Front reached an agreement on mutual cooperation at local level. These agreements resulted nothing but problematic. Both organization lacked trust. They both sought to gain control by undermining the other. The article treats the relationship between Fronti Nacionalçlirimtar dhe Balli Kombëtar as a process, trying to analyze the reasons why these rival organizations were transformed into sworn enemies.